



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2692/13 prot.

Datë 10.01.2024

V E N D I M

Nr. 37/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.01.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1341/2023, datë 20.12.2023 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-78172-08-23-2023, me objekt “Drurë shkurre Dekorative”, me fond limit 66,666,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.09.2023, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

Ankimues: Operatori ekonomik “Ulza” SHPK me NIPT J67902928O dhe adresë: Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga “Zef Jubani”, Ndërtesa 15, Hyrja 19, Ap.1, Kodi postar 1019, Tiranë.

Operatori ekonomik “A.M.E 2020” SHPK me NIPT K83725201G, me adresë: Ura e Gjolës, Nr. pasurie 421/6, Zonë Kadastrale 1299, Budull, Bubq, Durrës.

Operatori ekonomik “Agro - Korani” SHPK me NIPT L13329801V dhe adresë: Ura e Draxhit, Kavajë.

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit me adresë: Rruga “Xhezmi Delli”, Godina 20, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I****Rrethanat e çështjes**

I.1. Në datë 20.12.2023, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1341/2023, ku vendosi:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur të operatorit ekonomik “A.M.E 2020” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-78172-08-23-2023, me objekt “Drurë shkurre Dekorative”, me fond limit 66,666,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.09.2023, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.
2. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur të operatorit ekonomik “Agro - Korani” SHPK, për procedurën e prokurimit.
3. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Ulza” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
4. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “A.M.E 2020” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
5. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Agro Korani” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
6. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit.
7. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
8. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “Ulza” SHPK, “A.M.E 2020” SHPK dhe “Agro - Korani” SHPK.
9. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
10. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 22/2 prot., datë 05.01.2024, protokolluar me tonën nr. 2692/10 prot., datë 08.01.2024, autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 1341/2023, datë 20.12.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-

78172-08-23-2023, me objekt “*Drurë shkurre Dekorative*”, me fond limit 66,666,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.09.2023, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 22/2 prot., datë 05.01.2024, protokolluar me tonën nr. 2692/10 prot., datë 08.01.2024, autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 1341/2023, datë 20.12.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-78172-08-23-2023, me objekt “*Drurë shkurre Dekorative*”, me fond limit 66,666,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.09.2023, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik si dhe verifikimeve në SPE, konstatohet se autoriteti kontraktor ka zbatuar Vendimin Nr. 1341/2023, datë 20.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, duke anuluar procedurën e prokurimit në SPE në datën 08.01.2024.

II.2. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në rast se autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, do të ripublikojë procedurën e mësipërme të prokurimit, duhet të paraqesë në KPP kopje të dokumentave të tenderit ku të pasqyrohet zbatimi i vendimit Nr. 1341/2023, datë 20.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-

78172-08-23-2023, me objekt “*Drurë shkurre Dekorative*”, me fond limit 66,666,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.09.2023, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

2. Në rast ripublikimi të procedurës së mësipërme të prokurimit, autoriteti kontraktor të paraqesë në KPP kopje të dokumentave të tenderit ku të pasqyrohet zbatimi i vendimit Nr. 1341/2023, datë 20.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

